
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: Npt Bamirs me adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	02.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **02.05.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Npt Bamirs** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Npt Bamirs** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **22.04.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Npt Bamirs** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **22.04.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **02.05.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE E KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet te ketë në listën te paktën këtë staf professional

2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 8 vite pas diplomimit, duhet të jetë - Certifikatë si ekspert i sigurisë dhe shëndetit ne punë,- Të jetë i certifikuar si instruktor ne vendin e punës nga oda ekonomike e Kosovës, - Te jete i certifikuar si Auditor i Brendshem për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit ne punë, - Të jetë i certifikuar si përgjegjës per sigurimin dhe kontrollin e mjedisit;

-Në asnjë pozicion të paramasesë dhe paralogarise nuk shihet që do ketë nevoj që Inxhinieri i Ndërtimtarisë të jetë i nevojshem për këtë certifikim, përveq se një kërkesë diskriminuese, pasi që punet e tilla të cilat parashikohen të kryhen nuk e paraqesin nevojen për certifikime të tilla.

Kërkesa 8: Operatori Ekonomik duhet të posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi I obligueshëm sipas tabelës në **Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit;**

Kamion (Me Peshe bartëse mbi 15ton) 10 copë, Kamion (Kiper maksimum 3ton pesha bartëse) 2 copë, Kamionetë me Kran (maksimum 1ton pesha bartëse) 1 copë, Eskavatora (Makineri me Strukturë Rrotulluese me peshe totali mbi 48ton) 2 copë, Eskavatora (Makineri me Strukturë Rrotulluese me peshe totali deri 25ton) 3 copë, Buldazer mbi 12 ton 2 copë, Ngarkuesë me Zingjirë (Makineri me Strukturë Ngarkuesi me peshe totali mbi 18 ton) 1 copë, Ngarkuesë (Makineri me Strukturë Ngarkuesi me peshe totali mbi 18ton) 1 copë, Ngarkuesë (Makineri me Strukturë Ngarkuesi me peshe totali deri 8ton) 1 copë, Damper me pesh bartësi (mbi 2 ton) 1 copë, Ruler për ngjeshje (Cilinder) deri 12 ton 2 copë, Grejder (mbi 12 ton) 1 copë, Papuqe Vibruese 3 copë, Eskavator me Çekan 1 copë, Rimorkio (Me peshë bartëse mbi 12ton) 1 copë.

-Gjatë analizimit të pozicioneve të paramasesë dhe paralogarise nuk shihet që do ketë nevoj kaq të madhe për gjithë këtë makineri, përveq se një kërkesë diskriminuese, pasi që punet e tilla të cilat parashikohen të kryhen nuk e paraqesin nevojen për makinerin e tilla. Kjo punë mund të kryhet me: **Kamion (Me Peshe bartëse mbi 15ton) 4 copë, Eskavatora (Makineri me Strukturë Rrotulluese me peshe totali deri 25ton) 1 copë, Buldazer mbi 12 ton 1 copë, Ruler për ngjeshje (Cilinder) deri 12 ton 1 copë, Grejder (mbi 12 ton) 1 copë.**

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR:

Pretendimi ankimor te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nuk qëndron ngase përcaktimi i këtyre kriterëve, të këtyre kërkesave ka të bëjë lëndën së natyrës së Projektit në fjalë, dhe gjithashtu një kërkesë e tillë është e domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit në fjalë.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura, Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmime është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi në **pajtueshmëri me objektin e kontratës**.

Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në njoftimin për Kontratë sa i përket Kërkesave dhe dëshmime mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit